



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe 63.11 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenin 9.6 të Ligjit nr. 03/L-074 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 1.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 10/2009 “Raundi i Dytë i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave” si dhe nenin 1.1 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2009 “Fushata Zgjedhore dhe njoftimi për ngjarjet politike” dhe Vendimit për përsëritjen e votimit të Raundit të II të zgjedhjeve për Kryetar të komunave në komunën e Prizrenit dhe Lipjanit nr 1354/09 dt:23.12.2009, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 08.01.2010 nxjerr këtë:

VENDIM

Për caktimin e Fushatës Zgjedhore për përsëritjen e votimit të Raundin e II-të të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave në Prizren dhe Lipjan

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes këtij vendimi përcakton periudhën e fushatës zgjedhore për përsëritjen e votimit për Raundin e II-të të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave në Prizren dhe Lipjan që do të mbahet me 31 janar 2010 si në vijim:
 - *Periudha e Fushatës Zgjedhore për përsëritjen e votimit të Raundin e II-të të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave Prizren dhe Lipjan do të filloj me 25 janar 2010 (prej orës 00:00) dhe do të përfundoj me 29 janar 2010 (në orën 24:00).*
- II. Të gjitha aktivitetet zgjedhore të Subjekteve Politike dhe kandidatëve të tyre lidhur me Fushatën e Zgjedhjeve për përsëritjen e votimit për Raundin e II-të të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave zhvillohen në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi dhe Rregullën Zgjedhore nr. 13/2009 “Fushata Zgjedhore dhe njoftimi për ngjarjet politike”.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me 08 janar 2010.

Prishtinë, 08.01.2010

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve